



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) KERKON MIRATIMIN FEDERAL TE PLANEVE TE SHTETIT TE NJU JORKUT (NY STATE) PER PROGRAMET E STREHIMIT DHE TE RIMEKEMBJES SE BIZNESEVE NGA STUHIA

Shteti i Nju Jorkut (NYS) është shteti ose pushteti vendor i parë që nxjerr planin e veprimit për 1.7 miliardë dollarë fillestarë në fonde federale të CDBG-së për rimëkëmbjen nga katastrofa

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) paraqiti sot propozimin e Shtetit të Nju Jorkut (New York State) për programe të strehimit dhe të rimëkëmbjes së bizneseve për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të shkatërruar nga super stuhia Sendi (Sandy), si dhe uragani Irena (Irene) dhe stuhia tropikale Li (Lee). Këto programe do të sigurojnë miliarda dollarë në ndihmë të drejtpërdrejtë për individët, pronarët e shtëpive dhe bizneset e vogla duke përdorur fonde nga 60 miliardë dollarë të ndihmës për Sendin (Sandy) të miratuar nga Kongresi dhe të deklaruar si ligj nga Presidenti Obama në janar. Shteti caktoi sferën e shumëllojshme të programeve për të synuar posaçërisht ndihmën federale për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që kanë më shumë nevojë dhe për të siguruar se komunitetet e prekura dhe i gjithë rajoni rindërtohen në mënyrë më të zgjuar dhe më të fortë se më parë. Shteti i Nju Jorkut (New York State) është njësi e parë qeveritare e prekur që paraqet planin e saj të veprimit për miratim nga Departamenti i Strehimit dhe i Zhvillimit Urban të SH.B.A.-së (U.S. Department of Housing and Urban Development), agjencia e caktuar për të bashkërenduar reagimin e qeverisë federale ndaj super stuhisë Sendi (Sandy).

“Super stuhia Sendi (Sandy) ishte stuhia më e keqe që goditi Shtetin e Nju Jorkut (New York State) dhe rajonin tonë në historinë e regjistruar dhe goditja e saj shkatërroi shtëpi dhe biznese përgjatë Long Ajlvnd (Long Island) dhe zonës së metrosë,” tha Guvernatori Cuomo (Kuomo). “Falë punës së madhe dhe udhëheqjes së Delegacionit të Kongresit të shtetit tonë, Nju Jorku (New York) do të marrë miliarda dollarë në ndihmë federale për të ndihmuar pronarët e shtëpive dhe bizneset që të kryejnë riparimet dhe të rindërtojnë pas dëmit të shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy), si dhe uragani Irena (Irene) dhe stuhia tropikale Li (Lee). Ky plan u hartua me informacione nga pronarët e shtëpive dhe bizneset e vogla në komunitetet e prekura dhe do të shërbejë si një skicë për të drejtuar rimëkëmbjen tonë të strehimit dhe të sektorit privat.”

Në janar, Kongresi miratoi rreth 60 miliardë dollarë në fonde shtesë për të mbuluar dëmin e shkaktuar nga stuhitë që prekën Shtetet e Bashkuara, prej të cilave më shumë se 30 milionë pritet të shkojë në Shtetin e Nju Jorkut (New York State). Javën e kaluar, HUD nxorri rregulla dhe rregullore që drejtojnë përdorimin e 1.7 miliardë dollarëve të para të caktuara për Nju Jorkun (New York) dhe ftoi zyrtarisht Nju Jorkun (New York) që të bëjë kërkesë për fonde për të ndihmuar pronarët e shtëpive, bizneset e vogla dhe komunitetet e prekura nga Sendi (Sandy), Irena (Irene) dhe Li (Lee) me përpjekjet e vazhdueshme të rimëkëmbjes. HUD kërkohet të miratojë zyrtarisht programet e propozuara nga Shteti në programin e Financimit në Bllok të Rimëkëmbjes nga Katastrofa për Zhvillimin e Komunitetit (CDBG-DR) përpara sesa të mund të japin ndonjë prej këtyre fondeve për Shtetin. Programet e përvijuara sot do të ofrohen jashtë Qytetit të Nju Jorkut (New York City), pasi Qyteti i Nju Jorkut (New York City) do të administrojë programe të ngjashme për të përmbushur nevojat e njëjta brenda Qytetit duke përdorur shumën e tyre të caktuar nga CDBG-DR prej 1.7 miliardë dollarë.

Plani i veprimit i Shtetit është i disponueshëm për shqyrtimin publik në <http://www.nyshcr.org/Publications/>. Plani i Veprimit përfaqëson planin e shpenzimit vetëm për këtë shumë të caktuar të fondeve nga CDBG-DR dhe nuk pasqyron sferën e plotë të veprimtarive të rimëkëmbjes që po ndërmerren nga Shteti nëpërmjet programeve të tjera shtetërore dhe federale.

Sekretari i Strehimit dhe Zhvillimit Urban (Housing and Urban Development), që shërben gjithashtu si Kryetar i Forcës së Posaçme të Rindërtimit nga Uragani Sendi (Hurricane Rebuilding Sandy Task Force), tha, “Kemi punuar nga afër me Shtetin e Nju Jorkut (State of New York) për të identifikuar fushat e nevojës së papërmbushur dhe për të siguruar se ky raund i parë i fondeve nga CDBG-DR ndihmon familjet dhe bizneset e vogla që të rimëkëmben. Mbështetur në bisedimet tona, jemi të sigurtë se shteti është duke shkuar në drejtimin e duhur, megjithëse do të shqyrtojmë planet përfundimtare të veprimit dhe do të sigurojmë se përshtaten me kriteret për përdorimin që u botuan javën e kaluar. Mezi pres që të mbështetemi mbi partneritetin që kemi krijuar me Guvernatorin Cuomo (Cuomo) për të ndihmuar komunitetet në Nju Jork (New York) që të rindërtohen në një mënyrë që i bën më të forta, më konkurruese nga pikëpamja ekonomike dhe më të afta për të përballuar stuhinë e ardhshme.”

Në mënyrë që shteti të jetë në gjendje t’ua japë fondet banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) që kualifikohen për ndihmë, HUD duhet të miratojë zyrtarisht programet e propozuara nga Shteti. Nxjerrja e planit fillon një periudhë shtatë ditore të kërkuar federalisht për komente publike përpara shqyrtimit përfundimtar të HUD-it.

“Kemi punuar së bashku me partnerët tanë federale që ditën që goditi Sendi (Sandy) dhe çdo ditë që atëherë. Shteti do të sigurojë çfarëdo lloji ndihme dhe bashkëpunimi të nevojshëm për të parë që HUD të miratojë këto plane sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që t’ua japim këtë ndihmë banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) që kanë nevojë për të dhe që e meritojnë atë,” shtoi Guvernatori Cuomo (Cuomo).

Zyrtari i Qarkut Naso (Nassau County) Eduard P. Mangano (Edward P. Mangano) tha, “Keto fonde federale janë vendimtare në ndihmën për banorët tanë që të rimëkëmben nga dëmi i uraganit Sendi

(Sandy). Me këto programe, do të ndihmojmë në përmbushjen e nevojave të menjëhershme të pronarëve të shtëpive, të ndihmojmë bizneset në rimëkëmbje, në mënyrë që ekonomia jonë të mund të vazhdojë të rritet dhe të fillojë rindërtimin e komuniteteve tona në mënyrë më të fortë. Përgëzoj Guvernatorin Cuomo (Cuomo) për udhëheqjen dhe përkushtimin e tij në ndihmën që banorët e Nasos (Nassau) të rimëkëmben.”

Zyrtari i Qarkut Suffolk (Suffolk County) Stiv Bellone (Steve Bellone), “Qarku Suffolk (Suffolk County) sheh nga e ardhmja për të punuar me Shtetin e Nju Jorkut (New York State) për të administruar fondet nga CDBG tek të prekurit nga uragani Sendi (Sandy). Rindërtimi është një përparësi për banorët tanë dhe përgëzojmë Guvernatorin Cuomo (Cuomo) për krijimin e programeve vendimtare për të trajtuar nevojat e banorëve të Qarkut Suffolk (Suffolk County).”

Shumat e mëposhtme të caktuara të programit mbështeten në 1.7 miliardë dollarë fillestarë të vendosur në dispozicion të shtetit. Fonde të tjera në shuma të caktuara të mëvonshme do të vazhdojnë të trajtojnë këto fusha të nevojës.

STREHIMI

Deri në 300,000 shtëpi anembanë shtetit u dëmtuan në njëfarë mënyrë vetëm nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe rreth dy të tretat e të gjitha pronave të përmytura nga Sendi (Sandy) nuk ishin të mbuluara nga sigurimi për përmytje. Edhe aty ku pronarët e pronave kanë sigurim, në shumë raste ajo nuk i ka rimbursuar për shumën e plotë të nevojshme për të riparuar dëmin, duke lënë familje me një barrë të konsiderueshme për riparim dhe rimëkëmbje. Për më tepër, shumë familje nuk mund të përballojnë të investojnë në masa të lehtësimit të katastrofës për të pakësuar rrezikun e dëmit në të ardhmen, edhe pse këto investime janë me kosto të efektshme dhe shpëtojnë jetën në periudhën afat-gjatë. Për të ndihmuar pronarët e shtëpive të prekur nga këto tre stuhi që të rimëkëmben, Shteti i Nju Jorkut (New York State) po i kërkon HUD-it që të miratojë një sërë programesh strehimi për të ndihmuar që familjet të rindërtojnë shtëpitë e tyre në mënyrë më mirë dhe më të zgjuar.

Strehimi për një familje të vetme: 788 milionë dollarë:

- Rikrijimi i Financimeve për Riparimin dhe Rindërtimin e Zgjuar të NY - 233 milionë dollarë: Pronarët e shtëpive të vendosur në qarqet e prekura nga super stuhia Sendi (Sandy), uragani Irena (Irene) dhe stuhia tropikale Li (Lee), kostoja e të cilëve për të riparuar ose zëvendësuar shtëpinë e tyre tejkalon fondet që morën nga burime të tjera mund të kualifikohen për Financimet për Riparimin dhe Rindërtimin e Zgjuar të NY. Këto financime do të mbulojnë pjesën e mbetur ndërmjet rimbursimeve të mara dhe shumës së humbjes së pësuar nga pronari i shtëpisë. Për shembull, nëse një pronar shtëpie që pësoi 110,000 dollarë dëm ka marë tashmë 50,000 dollarë nga FEMA dhe ndërmarrja e tyre e sigurimit, ai mund të kualifikohet për një financim shtesë prej 60,000 për riparime që kualifikohen sipas këtij programi. Riparimi dhe restaurimi mund të kërkohen të përmbushin standartet e ndërtimit të gjelbërt dhe të përmirësojnë efektshmërinë e energjisë, atje ku është e zbatueshme.

- Rikrijimi i Financimeve Qëndrueshmëria e Shtëpisë së Zgjuar të NY - 259 milionë dollarë: Një pronar i shtëpisë prona e të cilit e dëmtuar pjesërisht gjendet në pjesën e përmbytjes 100 vjeçare ose prona e të cilit që gjendet jashtë pjesës së përmbytjes u dëmtua në mënyrë të konsiderueshme mund të kualifikohet për fonde për të mbështetur projekte të lehtësimit që pakësojnë rrezikun e dëmit të ardhshëm në shtëpitë e tyre. Projektet e mbështetura nga financimet do t'i bëjnë këto shtëpi në mënyrë të konsiderueshme më pak të prekshme ndaj dëmit të stuhive të ardhshme dhe do t'u kursejnë pronarëve në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet pagesave më të ulta të sigurimit për përmbytje. Në shumicën e rasteve, financimet do të mbulojnë koston e plotë të lehtësimit të tillë që nuk është mbuluar nga ndihma tjetër. Ndërtimi i lehtësimit mund të kërkohet të përmbushë standartet e ndërtimit të gjelbërt dhe të përmirësojë efektshmërinë e energjisë, atje ku është e zbatueshme.

- Rikrijimi i Programit të Blerjes së Zgjuar të Shtëpisë të NY - 171 milionë dollarë: Disa zona janë në rrezik të lartë për përmbytje të përsëritur, duke shkaktuar dëm tek shtëpitë dhe duke rrezikuar jetën e banorëve dhe të personelit të emergjencës. Për të pakësuar ato rreziqe dhe për t'u siguruar banorëve një mundësi për t'u larguar nga pronat e tyre, Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të ofrojë blerje vullnetare për shtëpitë që:

- ishin dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme brenda pjesës së përmbytjes 500 vjeçare, ose
- ndodhen brenda zonave të caktuara për blerje kur ndodhi dëmi dhe kur prona mund të jetë në rrezik për dëm në të ardhmen për shkak të ngritjes së nivelit të detit dhe faktorëve të tjerë. Këto zona të përmirësuara të blerjes do të përzgjidhen në këshillim me zyrtarë të qarkut dhe të pushtetit vendor.

Në zonat me rrezik shumë të lartë, do të ketë një ndalim të rindërtimit dhe këto zona do të përdoren si zona mbrojtje. Sipas propozimit të shteteve dhe pas miratimit nga HUD, rizhvillimi i pronës jashtë pjesës së përmbytjes 100 vjeçare që është blerë nëpërmjet një blerje do të lejohet, përsa kohë që struktura e re ndërtohet për të lehtësuar ndikimin e përmbytjes së ardhshme. Pronarët e shtëpive do të njoftohen nëse kualifikohen për një blerje pasi HUD të ketë miratuar këtë plan.

Pronarët e shtëpive që kualifikohen për një blerje do të marrin vlerën e plotë të drejtë të tregut përpara stuhisë për shtëpinë e tyre deri në kufirin e huasë nga FHA. Një stimul prej deri në 5% do të ofrohet gjithashtu për familjet që rivendosen brenda qarkut ose distriktit të shtëpisë së tyre.

Strehimi për familjet e shumta: 124 milionë dollarë:

- Financimet për Riparimin dhe Rindërtimin e Vogël për Familjet e Shumta - 31 milionë dollarë: Financimet do të jenë të disponueshme për të ndihmuar në restaurimin dhe/ose rindërtimin e pronave me 3 - 7 njësi që kanë pësuar dëm nga stuhia. Në të gjitha rastet, financime të tilla do të mbulojnë ato humbje që nuk janë kompensuar nga burime të tjera. Riparimi dhe restaurimi

mund të kërkohet të përmbushin standartet e ndërtimit të gjelbërt dhe të përmirësojnë efektshmërinë e energjisë, atje ku është e zbatueshme.

- Financimet për Lehtësimin e Vogël për Familjet e Shumta - 62 milionë dollarë: Financimet do të jenë të disponueshme për pronat me 3 - 7 njësi që ndodhen në pjesën e përmytjes 100 vjeçare për të mbështetur projektet e lehtësimit që pakësojnë rrezikun e dëmit në të ardhmen. Për të marrë financimet sipas këtij programi, pronarët e pronave për pronat me qira do të kërkohet të japin me qira një minimum prej 51% të njërive në pronë për banorët e Nju Jorkut (New Yorker) me të ardhura të ulta dhe mesatare. Në të gjitha rastet, financime të tilla do të mbulojnë kostot e lehtësimit të tillë që nuk kompensohen nga burime të tjera. Ndërtimi i lehtësimit mund të kërkohet të përmbushë standartet e ndërtimit të gjelbërt dhe të përmirësojë efektshmërinë e energjisë, atje ku është e zbatueshme.

- Financimet për Lehtësimin e Madh për Familjet e Shumta - 31 milionë dollarë: Pronarët e shtëpive që strehojnë familje të shumta, me prona që përmbajnë 8 ose më shumë njësi, pritet të mbajnë mbulim të përshtatshëm të sigurimit që do t'i kompensojë për dëme që kanë lidhje me stuhi. Duke pranuar se disa pronarë mund të mos investojnë vetë në projekte që kanë lidhje me lehtësimin për shkak të kostove fillestare të përfshira, Shteti i Nju Jorkut (New York State) propozon të sigurojë stimuj për t'i inkurajuar që të marrin masa që pakësojnë rreziqet për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që jetojnë në pronat e tyre. Financimet për lehtësimin mund të jenë të disponueshme për projekte të përzgjedhura që përmirësojnë në mënyrë të dukshme qëndrueshmërinë e ndërtesës ndaj stuhive në të ardhmen, si zhvendosjen e sistemeve elektrike nga bodrumet tek nivelet më të larta brenda ndërtesës. Kualifikimi është i kufizuar tek ndërtesat që kanë pësuar dëm nga Sendi (Sandy) dhe që ndodhen brenda pjesë së përmytjes 100 vjeçare. Financimet për ndërtime individuale do t'i nënshtrohen një shume fillestare për secilën ndërtesë. Ndërtimi i lehtësimit mund të kërkohet të përmbushë standartet e ndërtimit të gjelbërt dhe të përmirësojë efektshmërinë e energjisë, atje ku është e zbatueshme.

NDIHMA PER BIZNESIN

Super stuhia Sendi (Sandy) pati një ndikim të thellë negativ mbi ekonominë e Shtetit të Nju Jorkut (New York State) dhe ka dëmtuar mijëra biznese të vogla. Përveç kësaj, bizneset e vogla të prekura nga uragani Irena (Irene) dhe nga stuhia tropikale Li (Lee) vazhdojnë të përballen me nevojat që rrjedhin nga këto stuhi. Shteti propozon të përdorë 415 milionë dollarë për të ndihmuar bizneset që të zëvendësojnë ose riparojnë inventarin dhe pajisjet e dëmtuara, të riparojnë dhe të lehtësojnë mjediset e dëmtuara dhe të mbulojnë nevojat për kapitalin e punës.

Rikthimi i biznesit: 415 milionë dollarë

- Financimet për Bizneset e Vogla– 233 milionë dollarë: Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të drejtojë fonde të financimeve për të ndihmuar biznese, përfshirë veprimtari të fermave dhe bujqësore dhe organizatat jo-fitimprurëse që pësuan dëm fizik ose humbje të inventarit si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy), uraganit Irena (Irene) ose stuhisë tropikale Li (Lee).

Financime prej deri në 50,000 dollarë për të mbuluar humbje që kualifikohen, të pakompensuara janë propozuar për të lejuar që biznesi i prekur të blejë ose të riparojë pajisjet e nevojshme, të riparojë ose të rindërtojë mjediset që u dëmtuan ose u shkatërruan në stuhi dhe/ose të sigurojë kapitalin e punës të nevojshëm për të mbajtur dhe rritur biznesin. Shteti mund të japë financime deri në një shumë të financimit prej gjithsej 100,000 dollarë për bizneset që pësuan dëm fizik dhe që janë në rrezik të mbylljes ose humbjes së konsiderueshme të punësimit pa një rritje të madhësisë së financimit. Financime Speciale për Lehtësimin e Biznesit prej deri në 100,000 dollarë janë propozuar gjithashtu për të mbuluar shpenzime si instalimi i gjeneratorëve rezervë ose ngritja e pajisjeve kryesore, për të ndihmuar në parandalimin e dëmit për këto biznese në katastrofa në të ardhmen.

- Huatë për Bizneset e Vogla - 130 milionë dollarë: Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë një program të huave me interes të ulët për të ndihmuar bizneset e vogla, përfshirë veprimtari të fermave dhe bujqësore dhe organizata jo-fitimprurëse që janë në rrezik sepse pësuan humbje të inventorit ose pasuri fizike si rezultat i stuhisë. Hua prej deri në 1 milionë dollarë mund të jenë në dispozicion për të ndihmuar që këto biznese të blejnë ose të riparojnë pajisjet e nevojshme, të riparojnë dhe të rindërtojë mjediset që u dëmtuan ose u shkatërruan në stuhi dhe/ose të sigurojë kapitalin e punës të nevojshëm për të mbajtur dhe rritur biznesin. Hua të shumave më të larta mund të ofrohen për bizneset që kualifikohen që janë në rrezik të mbylljes ose humbjes së konsiderueshme të punësimit. Kushtet do të jenë fleksibël, me nivele interesi të mbajtura nën 2% për huamarrësit.

- Këshillimi për Biznesin, Udhëzimi & Shërbime të Tjera – 3 milionë dollarë: Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë një rrjet në internet për të lehtësuar lidhjet ndërmjet konsulentëve dhe praktikuesve të biznesit që janë të gatshëm të sigurojnë këshillim dhe shërbime të udhëzimit për bizneset e vogla të goditura rëndë nga stuhia. Deri në 3 milionë dollarë do të përdoren për të ndërtuar rrjetin dhe për të mbështetur siguruesit e këshillimit dhe shërbimeve të udhëzimit. Shërbime të tilla mund të përfshijnë administrimin financiar, pronat e paluajtshme, marketingun, ndihmë ligjore dhe specifike sipas industrisë.

- Programi i Rimëkëmbjes së Industrisë Bregdetare të Peshkimit – 20 milionë dollarë: Peshkimi bregdetar mbështet mijëra vende punë në Shtetin e Nju Jorkut (New York State). Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të konsiderueshëm të ndërmarrjeve të peshkimit përgjatë vijës bregdetare të Nju Jorkut (New York) dhe ndërsa këto ndërmarrje peshkimi gjithashtu do të jenë në gjendje të marrin pjesë në programe të tjera të ndihmës për bizneset e vogla të njoftuara sot, industria i nënshtrohet konsideratave të veçanta. Për të ndihmuar në rimëkëmbjen e kësaj industrie të rëndësishme, Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë një program të përcaktuar për të dhënë financime prej deri në 50,000 dollarë në dispozicion të bizneseve të prekura. Këto financime do të mbulojnë humbje përndryshe që kualifikohen, të pakompensuara dhe do të ndihmojnë industrinë që të përgatitet tani për sezonin e ardhshëm të peshkimit.

- Programi i Rimëkëmbjes së Industrisë së Turizmit Sezonal –30 milionë dollarë: Ndërsa këto biznese të turizmit sezonal do të kualifikohen gjithashtu për të marrë pjesë në programe të tjera të ndihmës për bizneset e vogla të njoftuara sot, bizneset e vogla sezonale në komunitetet bregdetare dhe përgjatë lumit kërkojnë një dhënie të menjëhershme të ndihmës për t'u siguruar se mund të rihapen dhe të funksionojnë në kohë për sezonin e ardhshëm të verës. Prandaj, Shteti kërkon të sigurojë financime prej deri në 50,000 dollarë për bizneset që kualifikohen në këtë industri. Financimet do të mbulojnë humbje përndryshe që kualifikohen, të pakompensuara dhe nevojat e kapitalit të punës për t'i ndihmuar që të përgatiten për sezonin e ardhshëm.

BANKA PER INFRASTRUKTUREN

Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë një bankë të përkushtuar për infrastrukturën për të ndihmuar në bashkërendimin e zhvillimit të infrastrukturës dhe të investimeve anembanë rajonit të katastrofës. Një kapitalizim fillestar prej 20 milionë dollarë nga shuma e parë e caktuar e fondeve nga CDBG-DR do të kombinohet me fonde të Shtetit dhe do të përkushtohet për financimin e projekteve që kualifikohen të infrastrukturës që bëjnë kërkesë për ndihmë përmes Bankës. Banka do të sjellë përfitim për Nju Jorkun (New York) duke paraqitur një metodë të centralizuar për marrjen e vendimeve që kanë lidhje me infrastrukturën sesa një proces projekt pas projekti sipas agjencisë. Fokusi i investimeve të Bankës do të jenë projekte që rrisin qëndrueshmërinë e infrastrukturës së zonës për të përballuar kërcënime në të ardhmen ose që sigurojnë dublikim të sistemeve vendimtare. Pritet që Banka të financohet me deri në 200 milionë dollarë nëpërmjet raundeve të mëpasshme të shumave të caktuara ose sasi të tilla të tjera për t'u përcaktuar së bashku me HUD-in.

Banka do të ndërmarë disa hapa për të realizuar këto qëllime, përfshirë krijimin e një sistemi për përcaktimin e përparësive të projekteve dhe iniciativave të infrastrukturës, duke siguruar një metodë të centralizuar për procesin e planifikimit të infrastrukturës së Shtetit, administrimin e fondeve të rimëkëmbjes për infrastrukturën të Shtetit dhe burime të tjera të kapitalit, bisedimin për mundësi për investimin e sektorit privat në infrastrukturë dhe projekte të miratuara të financimit. Proceset e planifikimit dhe ekspertiza e Forcës së Posatçme të Punës së Nju Jorkut (New York Works Task Force) do të përfshihet në funksionet e Bankës.

Banka mund të përdorë fonde nga disa burime, përfshirë fonde të rimëkëmbjes të caktuara në mënyrë federale, të ardhura të transferuara ose të krijuara, të ardhura nga shitja e borxhit afat-gjatë dhe përmirësime të kredisë me njësi të tjera shtetërore. Përveç kësaj, Banka do të punojë me investitorë publikë dhe privatë për të mbledhur fonde për financimin e zhvillimeve të infrastrukturës. Një avantazh që Banka do të ketë është aftësia për të kombinuar disa burime të ndryshme të fondeve (p.sh. fonde federale me fonde private) për të financuar projekte në mënyrë sa më të efektshme që të jetë e mundur. Banka do të paraqesë projekte të mundshme për të përfshirë sektorin privat në mundësi për investime në infrastrukturë.

PROGRAMI PER ZONAT E RINDERTIMIT TE KOMUNITETIT

Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë një program të Zonës së Rindërtimit të Komunitetit (CRZ) për të lehtësuar planifikimin e nxitur nga komuniteti për të rindërtuar dhe ringjallur komunitetet e dëmtuara rëndë. Shteti pret të caktojë rreth 25 milionë dollarë nga kjo shumë e pare e caktuar për të siguruar financime të planifikimit për komunitetet që pësuajnë pasoja në të gjithë komunitetin. Shuma të tjera të caktuara më vonë do të përdoren për të zbatuar planet përfundimtare të CRZ-së. Financimet e planifikimit do të lehtësojnë pajtimin e ekspertëve të jashtëm si konsulentë për një komitet të planifikimit të komunitetit pjesëmarrës, si dhe përfundimin e studimeve të rëndësishme për të përcaktuar pikat e dobëta dhe nevojat kryesore të komunitetit. Shteti do të sigurojë informacion dhe udhëzime për komitetet për t'i ndihmuar ata në identifikimin dhe përdorimin e burimeve të tilla të jashtme në mënyrë të efektshme dhe me efikasitet. Pritet që programi CRZ të financohet me deri në 500 milionë dollarë ose një shumë e tillë që do të përcaktohet me HUD-in.

FONDI PER QENDRUESHMERINE DHE RESTAURIMIN PER MJEDISET E RENDESISHME

Lehtësimi që ka lidhje me energjinë është vendimtar për mjediset e shërbimeve thelbësore, në veçanti spitale, azile dhe mjedise të tjera për popullsinë e prekshme. Shumë mjedise të shërbimeve thelbësore nuk kishin sisteme të energjisë rezervë ose kishin sisteme jo të efektshme rezervë që nuk funksionuan gjatë stuhisë. Si rezultat i kësaj, mjedise të shumta u desh të largonin pacientët, gjë që paraqiti një rrezik më të madh për ata pacientë sesa lejimi që të qëndronin në vend gjatë stuhisë.

Për të trajtuar këtë nevojë të rëndësishme, Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të krijojë Fondin për Qëndrueshmërinë dhe Restaurimin. Shteti pret caktimin e rreth 30 milionë dollarëve nga kjo shumë e parë e caktuar e financimeve nga CDBG-DR për të siguruar përmirësimin e kredisë ose aftësisë për financimin e sektorit privat të projekteve të lehtësimit që kanë lidhje me energjinë.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418